



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMIT

Nr. 35 Prot

Tiranë, më 13.09. 2006

VENDIM Nr. 5 dt. 12.09.2006

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimit në mbledhjen e datës 12.09.2006, pasi shqyrtoi projektet e miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës

VENDOSI:

1) Miratimin e projekteve të restaurimit:

- a) Rikonstrukcion "Banka e Shqipërisë"- Berat. (Investitori është i detyruar të zbatojë me përpikmëri projektin, zbatimi i të cilit do të mbikqyret prej IMK).
- b) Restaurim Banesa Nr. 96 Rruga "Tregtare", Durrës.
- c) Restaurim Kisha "Shën Maria", Voskopojë.
- d) Restaurim Kisha "Shën Kozma dhe Damianit" Vithkuq.
- e) Restaurim Kisha "Shën Gjergjit" Vithkuq.
- f) Sinagoga e Onhezmit dhe rrethinat e saj. (Plani për vazhdimin e gërmimeve, restaurimeve dhe krijimin e Parkut Arkeologjik). IMK është partner i këtij projekti.
- g) Sinagoga e Onhezmit dhe rrethinat e saj. (rikonstruksione të mëtejshme arkeologjike dhe përmirësimi i sitit). IMK është partner i këtij projekti.

2) Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.

3) Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

4) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


BUJAR LESKAJ
KRYETAR

SEKRETAR I K.K.R.

PROF. DR. APOLLON BAÇE

